



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA KORÇË

Korçë, më 21/12/2016

RAPORT I MBAJTUR NË TAKIMIN E BUXHETIMIT ME PJESËMARRJE ME BANORËT  
NJËSISË ADMINISTRATIVE VITHKUQ

Morën pjesë: Kryetari i Bashkisë Sotiraq Filo, staf i bashkisë, banorë të njësisë administrative Vithkuq dhe organizata të tjera të interesuara.

Në vijim të procesit të përgatitjes së projektbuxhetit për vitin 2017 takuam banorët e Njësisë Administrative Vithkuq në datë 21/12/2016, për të vendosur së bashku prioritetet e investimeve me qëllim përmirësimin e jetesës në çdo fshat ku ata jetojnë. Një diskutim i cili u mbështet tek punët dhe investimet e kryera gjatë kësaj kohe si dhe kërkesat e nevojat e tyre prioritare në lidhje me përmirësimin e ndriçimit dhe sistemit me ujë të pijshëm, sistemimin e rrugëve kryesore dhe dytësore, si dhe zgjidhjen e çështjes së kullotave dhe vendosjes së stallave të bagëtive.







